

MITET DHE TË VËRTETAT RRETH HOSPIS (HOSPICE)

HOSPIS ËSHTË...

MIT

Një vend – Nuk do të mundem të qëndroj në shtëpi.

MIT

Vetëm për personat me kancer.

MIT

Ofrohet vetëm për të moshuarit.

MIT

Një vend që mund të përdoret si zgjidhje e fundit.

E VËRTETË

Hospis është një filozofi kujdesi dhe mund të përfitohet sa herë që kërkohet nga pacienti apo njerëzit e dashur të tij. Hospis përfshin shtëpinë, një shtëpi të moshuarish të pajisur me staf të specializuar, një qendër rezidenciale kujdesi ose një shtëpi hospis.

E VËRTETË

Pjesa më e madhe e pacientëve të hospiseve janë pacientë që vuajnë nga kanceri. Megjithatë, nga kujdesi hospis mund të përfitojë çdo person që vuan nga një sëmundje që i kufizon jetën ose sëmundje terminale, qoftë ajo pamjaftueshmëri e zembrës, demencë, pamjaftueshmëri e veshkave ose sklerozë e shumëfishtë.

E VËRTETË

Shumica e institucioneve të kujdesit hospis ofrojnë shërbime për personat e të gjitha moshave, duke filluar nga fëmijët e deri tek të moshuarit.

E VËRTETË

Kur trajtimet mjekësore nuk mund të kurojnë më një sëmundje, profesionistët në hospis mund të bëjnë shumë gjëra për të kontrolluar dhimbjen, për të reduktuar ankthin, për të ofruar mbështetje shpirtërore dhe emocionale dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës për personat me sëmundje terminale dhe familjet e tyre.

HOSPIS DO TË THOTË...

MIT

Që mjekët e mi po heqin dorë nga unë.

MIT

Që po dorëzohem.

MIT

Që vdekja vjen më shpejt.

MIT

Që mjeku im më ka lënë në baltë.

MIT

Që mjeku im onkolog nuk do të kujdeset më për mua.

MIT

Nëse mjeku im më flet rreth hospis, do të thotë se po vdes.

E VËRTETË

Kjo nuk është aspak e vërtetë. Ka të bëjë me të jetuarin më gjatë, në mënyrë komode dhe me dinjitet. Fokusi i kujdesit është lehtësimi i dhimbjes dhe simptomave të tjera të sëmundjes, jo përpjekja për të kuroar sëmundjen.

E VËRTETË

Të zgjedhësh kujdesin hospis do të thotë të zgjedhësh të fokusohesh në cilësinë e jetës, me sistemin më të mirë të mbështetjes.

E VËRTETË

Qëllimi i kujdesit në hospis nuk është as zgjatja e jetës e as përsheptimi i vdekjes, por përmirësimi i cilësisë së jetës së pacientit në cilësinë më të mirë të mundshme për muajt, javët ose ditët e tij të fundit. Studimet tregojnë se pacientët jetojnë më gjatë dhe kanë cilësi më të mirë jete kur marrin kujdes hospis.

E VËRTETË

Hospis është kujdes mjekësor mbështetës, i cili është më i përshtatshëm se kujdesi kurativ për personat me sëmundje terminale. Mjeku mund të inkurajojë marrjen e kujdesit hospis, pasi ai fokusohet në menaxhimin e simptomave dhe trajtimin e qetësisë shpirtërore, emocionale dhe psikologjike.

E VËRTETË

Ju mund të vazhdoni të shihni onkologun tuaj ndërkohë që merrni kujdes në hospis. Onkologu juaj do të ndalojë të gjitha mjekimet kimioterapeutike, por do të vazhdojë të ofrojë mbështetje për menaxhim të simptomave dhe mbështetje psikologjike dhe emocionale.

E VËRTETË

Kërkimet kanë treguar se mjekët duhet të flasin me pacientët rreth hospis shumë herët, shumë përpara se t'u nevojitet. Kjo u jep pacientëve mjaftueshëm kohë për të menduar dhe planifikuar se çfarë duan. Gjithashtu, u jep pacientëve mjaftueshëm kohë për t'u treguar familjarëve dhe miqve dëshirat e tyre përpara se të jenë shumë të sëmurë.

GJATË QËNDRIMIT NË HOSPIS...

MIT

Më duhet të qëndroj në hospis edhe pse kam ndryshuar mendje.

MIT

Mjekimet dhe trajtimet ndërpriten dhe nuk ofrohen më.

MIT

Pacientëve u privohet ushqimi dhe/ose hidratimi.

MIT

Jepet morfinë për të shkaktuar vdekje të hershme ose të parakohshme.

E VËRTETË

Hospis është kujdes mjekësor mbështetës, i cili është më i përshtatshëm se kujdesi kurativ për personat me sëmundje terminale. Mjeku mund të inkurajojë marrjen e kujdesit hospis, pasi ai fokusohet në menaxhimin e simptomave dhe trajtimin e qetësisë shpirtërore, emocionale dhe psikologjike.

E VËRTETË

Përkundrazi, në hospis përdoren mjekime dhe trajtime për të lehtësuar dhimbjet dhe simptomat dhe për të mbajtur pacientët të qetë për aq gjatë sa të jetë e nevojshme.

E VËRTETË

Kur bëhet fjalë për ushqyerjen dhe hidratimin e pacientëve që janë afër fundit të jetës, duhen marrë parasysh shumë gjëra. Meqenëse përparimi i natyrshëm i sëmundjes së pacientit ndikon në aftësinë e trupit për të përpunuar ushqimet dhe lëngjet, pritet që pacientët me sëmundje terminale të fillojnë të hanë dhe të pinë gjithnjë e më pak.

E VËRTETË

Mjekët e hospis janë të trajnuar posaçërisht për përdorimin e morfinës dhe e japin atë vetëm në dozën që është e nevojshme për të lehtësuar dhimbjen e pacientit dhe për ta ndihmuar atë që të marrë frymë. Kur administrohet si duhet, morfina ndihmon që pacientët me sëmundje terminale të kenë një cilësi më të mirë jete.

MË SHUMË TË VËRTETA

MIT

Unë jetoj vetëm dhe nuk kam asnjë familjar, për këtë arsye nuk mund të qëndroj në hospis.

MIT

Të gjitha institucionet e kujdesit hospis kanë përkatësi fetare ose shpirtërore.

MIT

Jam i/e detyruar të zgjedh hospis.

MIT

Kur të marr familjarin tim që është në hospis në shtëpi, duhet të lë punën për të qenë kujdestari kryesor i tij.

MIT

Unë nuk jam i siguruar dhe për këtë arsye nuk mund të përfitoj nga shërbimi hospis.

MIT

Mjeku im më tha se mund të shkoj në hospis dhe infermieri në hospis më tha se nuk kualifikohem, prandaj nuk mund të regjistrohem.

MIT

Kam dëgjuar se kur një person shkon në një qendër kujdesi hospis, ai mund të vazhdojë të marrë fatura dhe kostoja mund të jetë e konsiderueshme.

E VËRTETË

Ju mund të regjistroheni në hospice edhe nëse jetoni vetëm. Hospis do t'ju ndihmojë që të përcaktoni planin e duhur të kujdesit për ju.

E VËRTETË

Hospis ofron faltore dhe këshilltarë të tjerë shpirtërorë të të gjitha feve dhe besimeve. Ata respektojnë të gjitha kulturat dhe pikëpamjet dhe janë aty për të dhënë mbështetje dhe për të diskutuar për ndjenjat dhe pikëpamjet e pacientit dhe të familjes.

E VËRTETË

Hospis është një përfitim fakultativ. Ju mund të zgjidhni ta përdorni, ose jo. Është në dorën tuaj.

E VËRTETË

Nuk është e nevojshme të lini punën nëse një anëtar i familjes merr shërbim hospis. Flisni për situatën tuaj me shërbimin hospis dhe punëdhënësin tuaj.

Ka opsione.

Kur shërbimi hospis ofrohet në një shtëpi private, klinikistë të licencuar vijnë në shtëpinë e pacientit në vend që pacienti të shkojë në zyrën e mjekut. Familjarët ose miqtë marrin rolin e kujdestarit kryesor, të mbështetur nga një ekip me profesionistë të shërbimit hospis, duke përfshirë një infermier, ndihmës, mjek, punonjës social dhe këshilltar shpirtëror. Ekipi bën vizita të rregullta të planifikuara, trajnon dhe edukon personat e familjes që kujdesen për pacientin. Në rast urgjence, stafi i hospis është i disponueshëm në telefon 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.

Nëse një pacient jeton në një qendër rezidenciale kujdesi ose shtëpi të moshuarish, ekipi i hospis ofron kujdes shtesë që plotëson kujdesin që pacienti po merr tashmë në atë vend.

E VËRTETË

Hospis ndihmon individët ose familjet që nuk kualifikohen për ndihmë federale ose shtetërore dhe nuk janë të siguruar që të gjejnë burime të disponueshme. Opsionet e disponueshme të pagesës përfshijnë vetëpagesën dhe ndihmën nga organizata bamirëse.

E VËRTETË

Për fat të keq, ka raste ku një pacient gjendet përballë dy mendimeve të ndryshme nga dy profesionistë të ndryshëm. Nëse ju ndodh diçka e tillë, ju lutemi të kontaktoni klinikën tuaj të onkologjisë dhe të flisni me infermierin e mjekut tuaj. Ai do të kontaktojë shërbimin hospis dhe të trajtojë situatën.

E VËRTETË

Nuk ka arsye për të shtyrë kujdesin në hospis për motive financiare nëse jeni të siguruar. Hospis zakonisht ka kosto më të ulët se kujdesi i zakonshëm. Hospis është një përfitim me gjithçka të përfshirë që mbulohet nga Medicare, Medicaid dhe shumica e kompanive private të sigurimit. Përfitimi Hospis i Medicare mbulon 100% të shërbimeve që lidhen me sëmundjen terminale pa asnjë bashkëpagesë ose shpenzim nga xhepi.

Është më mirë që të flisni me ofruesin tuaj të kujdesit hospis i cili e kupton sigurimin tuaj për të ditur saktësisht se çfarë do të mbulohet nga përfitimi juaj.

MOQC
MICHIGAN ONCOLOGY
QUALITY CONSORTIUM



Nonprofit corporations and independent licensees
of the Blue Cross and Blue Shield Association

Pyetje?

PËR MË SHUMË INFORMACION, PYESNI MJEKUN
TUJ RRETH SHËRBIMEVE HOSPIS NË ZONËN TUJ.